

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Bed & Breakfast": Në Durrës, bizneset po heqin dorë nga numërimi i turistëve
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/13/bed-breakfast-ne-durres-bizneset-po-heqin-dore-nga-numerimi-i-turisteve/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 06:00:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 05:47:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5b06814b2d9c58f64ff6ceeb734cf1574f27e8110bff594f1530db279400a648
TEKSTI	dc4e83f3899600a063bfadd123f69cfe7dc86175ec776f468e9b46117ed2b19c
PAMJA	2d0507c655af23373b4354a702b6f1d7ab7094ca7013b072a257bf905e0aef7e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	96d75bbda8476b3de4e6c35fa5fe85cbc0af4fa78fa4eb890a1100e38272fdee
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5e97407bb1567bb3877f809f8217470d0d3544ef3905c908120b91ac492e3b20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/96d75bbda8476b3de4e6c35fa5fe85cbc0af4fa78fa4eb890a1100e38272fdee>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Reportazhe

"Bed & Breakfast": Në Durrës, bizneset po heqin dorë nga numërimi i turistëve

Edhe pse kanë mikpritur një numër rekord turistësh gjatë këtij viti, bizneset në qytetin e Durrësit janë në dilemë nëse ky ishte një sezon i suksesshëm sa i përket të ardhurave.



nga Gëzim Kabashi — 11 seconds më parë në Artikull kryesor, Reportazhe

Koha e leximit: 3 min lexim

AA 0



Plazhi i Sfinksit | Foto: G. Kabashi

Në trotuarin pranë Muzeut Arkeologjik në qytetin e Durrësit, një grup turistësh tërheqin zvarrë valixhet dhe komunikojnë në telefon për të saktësuar adresat ku do të qëndrojnë.

Kjo është një pamje e zakonshme e ditëve të shtatorit në Durrës, qytetit që vazhdon të jetë mikpritësi më i madh veror i turistëve në shkallë vendi.

"Kur mendon se 40 vjet më parë kjo lagje thuhet nuk ekzistonte, habitesh," thotë për BIRN Xhevdet Kalaja, 75 vjeç, ndërsa tregon lagjen pranë portit detar që filloi të ndërtohej në vitin 1987.

"Edhe aty ku ndodhej një fushë futbollit me rërë të ngjeshur në breg të detit, gjatë këtyre viteve janë ngritur pallate pa fund," shtoi ai.

Ndërtimet e shumta në lagjen nr.1 të Durrësit po shërbejnë gjatë viteve të fundit si shtëpi pritjeje për një numër në rritje të turistëve vendas dhe të huaj. Çmimet në këtë zonë janë rritur me 40-50 për qind, çka i ka detyruar shumicën e pensionistëve italianë që të zhvendosen drejt zonës së plazhit në jug të qytetit.

"Një pjesë e madhe e turistëve kanë shfrytëzuar "Bed & Breakfast, apartamentet e banorëve, të cilat tashmë nuk jepen me qira mujore, por vetëm për pak ditë ç'ka e ka rritur fitimin e tyre," thotë Remzi Taka, një nga administratorët e pallateve të lagjes.

Sipas tij, në çdo pallat ka tashmë apartamente që jepen me qira ditore për pushuesit, ndërkohë që të tjerë banorë po i adaptojnë shtëpitë e tyre për të njëjtin qëllim.

"Kemi patur punë më shumë se sa çdo vit tjetër," thotë Margarita Roçi, e cila punon prej vitesh në një furrë buke. Në dyqan hyn një grua e huaj me rroba banje për të blerë bukë. "Jemi bërë si në Florida," thotë me humor Margarita.

Pak metra më tutje, turistët mbajnë radhën përpara dyqaneve për të blerë zarzavate dhe fruta. Por jo të gjithë e miratojnë këtë lloj pushimi turistik.

Shumica e restoranteve të bregdetit këtë verë kanë më pak klientë dhe kjo lidhet me shtimin e apartamenteve të lëshuara me qira.

"Bed & Breakfast": Në Durrës, bizneset po heqin dorë nga numërimi i turistëve

07:47 | 13/09/2026

'PISA 2025': Pasqyra e deformuar e suksesit të qeverisë me arsimin

08:31 | 12/09/2026

Qeveria jep 90 mijë m2 me 1 euro për investimin strategjik në Gjirin e Lalëzit

16:53 | 11/09/2026

Gjykata urdhëron Ministrinë e Financave që të zhblokojë pagat e GJKKO

13:51 | 11/09/2026

Rama shkarkon ministrin e Brendshëm pa motivacion publik

11:43 | 11/09/2026

Një vilë në këmbim të tenderit, SPAK: Si e fshehu Balluku pronën e dytë në Palasë

06:57 | 11/09/2026

